



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 628 Akti

Nr. 732 Vendimi

Tiranë, më 15.1.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 12.1.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Nertila Kape**, gjyqtare pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Steven Kessler, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Nertila Kape, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Nertila Kape ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.12.2020 dhe iu nënshtrua procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përzgjedhur me short, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari (kryesuese), Firdes Shuli (anëtare) dhe Olsi Komici (relator), ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua z. Steven Kessler.
3. Me vendimin e datës 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Nertila Kape për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; rivlerësimin e aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike¹, ku iu komunikua përbërja e trupit gjykues dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit, nëse do të kishte me ndonjë nga anëtarët e tij.
4. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit standard deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
6. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Nertila Kape, si dhe e njoftoi për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 28.12.2023² mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht i kryer nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 9.1.2024. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar brenda afatit të caktuar nga Komisioni pranë zyrës së protokollit shpjegimet dhe provat përkatëse.

¹ Subjekti u njoftua po në datën 21.1.2021 me anë të postës elektronike, me *email*.

² Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë me rrugë elektronike, *email*.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit u ftua në datën 10.1.2024 në seancën dëgjimore, e cila do të zhvillohej më 12.1.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0, Tiranë.

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.1.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit Nertila Kape u paraqit personalisht dhe parashtroi shpjegimet dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Nertila Kape ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b, Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes, duke vlerësuar edhe hetimin e kryer nga organet e tjera ndihmëse, por pa u ndikuar nga konstatimet përfundimtare të tyre.

13. Për subjektin e rivlerësimit Nertila Kape, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin tri kritere: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Pas analizimit të raporteve dhe dosjeve përkatëse të depozituara në Komision nga organet e tjera ndihmëse, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e hetimit kryesisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. ILDKPKI-ja³, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Nertila Kape, e cila është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2014, me nr. indeksi ***, dhe në përfundim të veprimeve verifikuese ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje pasurie;

³ Raporti nr. *** prot., datë 16.1.2018, i ILDKPKI-së.

- nuk ka kryer deklarin të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Mbi asetet e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016

❖ Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit

1. Bashkëpronësi mbi tokën bujqësore me sip. 10,630 m², ndodhur në fshatin *, Pogradec.** Pjesa takuese: 16,6%. Burimi i krijimit: Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi⁴, i dhënë në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”.

1.1 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti që në deklaratën e para fillimit të detyrës të vitit 2014 (në vijim DPFĐ) me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*.

1.2 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka rezultuar se me AMTP-në nr. ***, datë 21.7.1992, familjes së shtetasit H. M. (babait i subjektit) në fshatin *** i jepen 9,230 m² arë + 1,400 m² pemëtore = 10,630 m². Sipas certifikatës së përbërjes familjare të shtetasit H. M., rezultojnë 6 persona, ku ndër ta edhe subjekti i rivlerësimit Nertila M. (Kape).

1.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës – Drejtoria Vendore Pogradec (në vijim ASHK)⁵ nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo/dhe të personave të lidhur me të.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë e lartpërmendur.

2. Llogari bankare në Raiffeisen Bank me gjendje në datën 27.1.2017, në shumën 30,497,71 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga.

2.1 Subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar dokumentin “Nxjerrje llogarie” të Raiffeisen Bank, ku vërtetohet llogaria e pagës dhe gjendja e deklaruar në datën 27.1.2017.

2.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin llogarinë e pagës në Raiffeisen Bank.

3. Hua në datën 2.5.2012, dhënë shtetasit R. T., në shumën 2,000 USD. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: dhuratë nga prindërit.

3.1 Huaja prej 2,000 USD është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në DPFĐ-në e vitit 2014 me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*.

3.2 Bashkë me deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 28.10.2016⁶, me deklarues prindërit e subjektit, H. e L. M., të cilët deklarojnë se i kanë dhuruar vajzës së tyre Nertila Kape shumën 2,000 USD në datën 30.4.2012, si dhe 2,500 euro në datën 15.7.2014.

3.3 Subjekti ka depozituar dokumentacionin për të ardhurat e realizuara ndër vite nga shtetasit L. e H. M.⁷.

⁴ AMTP-ja nr. regj. *** akti, datë 21.7.1992.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2021, e ASHK-së Pogradec.

⁶ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.10.2016, e shtetasve H. e L. M., depozituar nga subjekti në ILDKPKI.

⁷ Vërtetim datë 24.10.2016, i Qendrës Arsimore të Bashkisë Pogradec, për të ardhurat e punësimit të shtetas L. M. për periudhën janar – shtator 2016; vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, i Zyrës Arsimore Pogradec, për të ardhurat e punësimit

3.4 Komisioni, me pyetësin nr. 2, i kërkoi subjektit shpjegime për lidhjen me shtetasin R. T., dokumentin ligjor që vërteton dhënien e kësaj shume, nëse kjo hua është kthyer nga ky i fundit apo jo, si dhe periudhën e kthimit. Gjithashtu, meqenëse shuma 2,000 USD i ishte dhuruar subjektit nga prindërit vetëm dy ditë përpara se të jepej kjo hua, subjektit iu kërkua të sqaronte nëse ky dhurim ishte i destinuar për t'u dhënë hua.

3.4.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shtetasi R. T., i lindur në *** dhe banues në Tiranë, është shok fëmijërie me bashkëshortin e saj E. K.. Shtetasi R. T., për shkak të vështirësive që kishte, i kërkoi bashkëshortit të subjektit një shumë të hollash, të cilat do t'ia kthente në një kohë të shkurtër. Duke marrë parasysh marrëdhënien e besimit që kishte krijuar ndër vite, bashkëshorti i ka dhënë hua shumën 2,000 USD, të cilën subjektit ia kishin dhuruar prindërit. Huaja e dhënë shtetasit R. T. provohet me deklaratën noteriale të datës 5.2.2020⁸. Në kushtet kur me kalimin e viteve kjo shumë nuk po kthehej, subjekti i rivlerësimit ka vijuar me procedurat ligjore për kthimin e saj, ku nga ana e gjykatës është lëshuar urdhri i ekzekutimit për titullin ekzekutiv deklaratë noteriale e datës 5.2.2020, e debitorit R. T., për ekzekutimin e detyrimit prej 2,000 USD ndaj kreditorëve E. dhe Nertila Kape.

3.4.2 Subjekti ka shpjeguar se për ekzekutimin e titullit ekzekutiv i është drejtuar zyrës përmbartimore, e cila ka marrë vendimet përkatëse, megjithëse deri në datën 15.11.2023 shtetasi R. T. nuk e ka shlyer detyrimin⁹.

3.4.3 Subjekti më tej shpjegon se prindërit e saj nuk e kanë njohur shtetasin R. P. T. dhe nuk kanë pasur dijeni lidhur me huan. Kështu, dhënia e huas pak ditë pasi shuma 2,000 USD i ishte dhuruar asaj nga prindërit, ka qenë rastësi.

❖ **Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të shumës 2,000 USD.**

3.4.4 Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 2,000 USD, dhuruar subjektit të rivlerësimit nga prindërit e saj, subjekti ka shpjeguar se meqenëse nuk ka bërë ceremoni martesore sipas traditës, kjo shumë i është dhënë nga prindërit në cilësinë e dhuratës së martesës. Për burimin e shumës 2,000 USD subjekti ka shpjeguar se kanë shërbyer të ardhurat nga puna e nënës L. M. prej vitit 1988 deri në vitin 2019, të ardhurat nga pensioni i babait H. M. nga viti 1995 e në vijim, të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore të realizuara, të cilat janë prodhuar në tokën e llojit arë dhe pemëtore, e përfutuar me AMTP në fshatin ***, Pogradec. Subjekti thekson se prej momentit kur kjo sipërfaqe toke është ndarë e në vazhdim, deri në vitin 2017, për shkak të distancës së shkurtër nga vendbanimi, qyteti Pogradec, prindërit e saj kanë punuar në të, duke mbjellë dhe prodhuar produkte të ndryshme bujqësore, nga të cilat një pjesë kanë shërbyer për familjen dhe një pjesë tjetër është shitur, duke u shndërruar në burim të ardhurash¹⁰.

të shtetas L. M. për periudhën janar 2008 – nëntor 2015; librezë pune e shtetas L. M.; vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, i DRSSH-së Korçë, për shtetasin H. M., për pension pleqërie në masën 15,080 lekë, filluar që në datën 31.12.1995;

⁸ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.2.2020, e shtetasit R. T., depozituar nga subjekti bashkë me pyetësin nr. 2.

⁹ Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) deklaratën noteriale datë 5.2.2020, me deklaruës shtetasin R. T.; (ii) vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 2.11.2020, për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit; (iii) praktikën e përmbartimit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

¹⁰ Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) librezën e punës së nënës së saj L. M., në të cilën pasqyrohet punësimi i nënës nga data 21.12.1998 si edukatore kopshti dhe deri në korrik 2012, por nuk evidentohet paga e marrë për periudhat e punësimit; (ii) listë e kontributeve nga ISSH-ja për nënën e saj nga dhjetori i vitit 2011 e në vijim; (iii) vërtetim pensioni nr. *** prot., datë 24.10.2016, për shtetasin H. M., lëshuar nga ISSH-ja Pogradec, sipas të cilit babai i subjektit përfiton pension pleqërie me nr. *** dhe në masën aktuale 15,080 lekë; (iv) AMTP nr. akti ***, datë 21.7.1992, nga fshati ***, Pogradec, nga i cili vërtetohet se i jepet në pronësi shtetasit H. M. 10,630 m² tokë dhe AMTP nr. akti ***, fshati ***, i jepet shtetasit N. K. 11,850 m² tokë në pronësi.

3.4.5 Subjekti shpjegon se nuk mund të identifikojë shumat konkrete të të ardhurave dhe kursimeve të krijuara nga prindërit për çdo vit/periudhë, por siç i kanë shpjeguar ata, kanë qenë kursime të krijuara ndër vite.

3.4.6 Gjithashtu, subjektit iu kërkua të japë sqarime edhe për burimin e të ardhurave për krijimin e shumave të konsiderueshme të këmbryera nga lekë në USD, euro dhe anasjelltas, gjatë periudhës 2008 – 2010, lëvizje të evidentuara në llogaritë bankare të babait të saj pranë Union Bank.

3.4.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nga sa i ka thënë babai i saj, si burim për to kanë shërbyer kursimet ndër vite të familjes nga puna, shitja e prodhimeve bujqësore, si dhe një pjesë edhe nga shumat e dërguara si dhuratë për babain dhe familjen nga xhaxhai V. M., i cili prej vitit 1998 jeton dhe punon në SHBA. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion për të ardhurat nga toka bujqësore, si dhe për dërgesa parash nga xhaxhai i saj.

3.5 Për të verifikuar mundësinë financiare të prindërve të subjektit për të kursyer shumën 2,000 USD në datën 30.4.2012, subjektit iu kërkua të deklarojë përbërjen e familjes së saj të origjinës për periudhën kur janë kursyer shumat që i janë dhuruar.

3.5.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se ata kanë qenë pesë anëtarë: subjekti, prindërit, vëllai dhe motra e saj deri në janar të vitit 2011, ndërsa nga janari i vitit 2011 kanë qenë 4 persona, pasi subjekti ka jetuar në Tiranë me të fejuarin e saj, pavarësisht se ajo figuron në një certifikatë familjare me prindërit nga janar – korrik 2011, kur subjekti ka lidhur martesë ligjore.

3.5.2 Për të provuar deklaratimet e mësipërme në lidhje me përbërjen familjare, subjekti ka paraqitur disa certifikata familjare, nga ku rezulton se për periudhën para vitit 2010 kanë qenë pesë anëtarë në familje, sikundër provohet edhe me certifikatën familjare të vitit 2005; certifikatat familjare për periudhën janar 2010 – korrik 2011; për periudhën korrik 2011– dhjetor 2014 (prindërit, vëllai dhe motra).

3.6 Komisioni ka kryer një vlerësim të situatës financiare të prindërve të subjektit deri në datën e dhënies së dhuratës. Me të dhënat e administruara deri në këtë fazë të hetimit administrativ, sipas tyre ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme nga pagat dhe pensionet për periudhën 2007 – 30.4.2012, në total në shumën 2,567,380 lekë¹¹.

3.7 Duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit që prindërit e saj kanë përfutur të ardhura nga toka bujqësore në pronësi të tyre, si dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, pavarësisht se subjekti nuk ka mundur të provojë shuma konkrete të përfutura, shpenzimet e jetesës së prindërve janë reduktuar në zero, duke u konsideruar si të mbuluara nga përdorimi i produkteve bujqësore. Gjithashtu, Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se bëhet fjalë për një vlerë minimale, e cila në çfarëdolloj situatë nuk ndikon në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur me të.

Si konkluzion, prindërit e subjektit kanë pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojnë shumën prej 2,000 USD për t'ia dhuruar subjektit të rivlerësimit.

¹¹ Të ardhurat e nënës së subjektit janë në vlerën 1,885,333 lekë dhe janë evidentuar nga lëvizjet e llogarisë në BKT nga prilli i vitit 2007 dhe nga vërtetimi i pagës së saj nga Zyra Arsimore Pogradec. Të ardhurat e babait nga pensioni i tij për të njëjtën periudhë janë në totalin 628,047 lekë. Ato janë bazuar në të dhënat e administruara nga Komisioni dhe konkretisht: masa e pensionit mujor për vitin 1995 është 3,450 lekë dhe për vitin 2016 është 15,080 lekë. Kështu, masa e pensionit për vitet 2007 deri 2014 është përlogaritur nga Njësia e Shërbimit Ligjor, duke konsideruar që rritja e pensionit nga viti 1996 deri në vitin 2006 është bërë në mënyrë uniforme (e barabartë për çdo vit).

4. Hua në datën 5.1.2014, dhënë hallës M. J., në shumën 500,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursime nga shpërblimi në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2012 – janar 2014).

4.1 Huaja prej 500,000 lekësh është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në DPDFD-në e vitit 2014 me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*.

4.2 Bashkë me deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 12.12.2016¹² me deklaruese shtetasen M. J., e cila deklaron: “*Më 5.1.2014 i kam marrë hua mbesës sime Nertila Kape shumën prej 500,000 lekësh për një afat të pacaktuar dhe sot, në datën 12.12.2016, deklaroj se nuk e kam kthyer ende këtë hua*”.

❖ Komisioni ka analizuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 500,000 lekë, dhënë hua hallës së saj.

4.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim për krijimin e shumës 500,000 lekë kanë shërbyer kursimet nga shpërblimi në Shkollën e Magjistraturës, për periudhën tetor 2012 – janar 2014.

4.3.1 Në pyetësonin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se për periudhën e mësipërme të ardhurat e krijuara si rezultat i bursës nga Shkolla e Magjistraturës janë 655,350 lekë, nga të cilat 500,000 lekë i janë dhënë hua hallës M. J. në datën 5.1.2014. Në total, për periudhën tetor 2012 – tetor 2014, të ardhurat e subjektit kanë qenë 1,127,202 lekë dhe 2,500 euro. Nga këto të ardhura janë kursyer 500,000 lekë, të cilat i janë dhënë hua hallës, si dhe 2,000 euro, të cilat janë burim i gjendjes *cash* në datën 30.10.2014. Ndërkohë, pjesa tjetër është shpenzuar për jetesën. Gjithashtu, për të mbuluar shpenzimet e jetesës, kanë shërbyer të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit E. K..

4.3.2 Për të verifikuar mundësinë e subjektit për të kursyer shumën 500,000 lekë nga bursa e Shkollës së Magjistraturës për periudhën tetor 2012 – janar 2014, për efekt të analizës financiare është pyetur subjekti se si janë përballuar shpenzimet e saj gjatë periudhës së studimeve.

4.3.3 Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti ka deklaruar se për të mbuluar shpenzimet e jetesës, kanë shërbyer: (i) të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit E. K. si specialist prokurimesh në Ministrinë e Financave¹³; (ii) pjesa e mbetur e të ardhurave të saj nga Shkolla e Magjistraturës pas kursimit të shumës 500,000 lekë dhënë hua hallës; (iii) ndihma në mënyrë të vazhdueshme nga fillimi i bashkëjetesës (janar 2011 e në vijim) nga të dyja familjet e origjinës, me prodhime bujqësore të prodhuara nga puna e secilës prej tyre në tokat bujqësore¹⁴, çka ka sjellë që shpenzimet e tjera të mbuluara nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të jenë minimale.

4.3.4 Nga analiza e kryer për periudhën 31 tetor 2012 deri në momentin e dhënies së huas, datë 5.1.2014¹⁵, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Nertila Kape ka pasur mundësi të kursente shumën 500,000 lekë nga shpërblimet e Shkollës së Magjistraturës dhe për ta dhënë këtë shumë

¹² Deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.12.2016, me deklaruese M. J..

¹³ Subjekti ka bashkëlidhur gjendjen e llogarisë së pagës të shtetasit E. K. në Intesa Sanpaolo Bank nga viti 2011 e në vijim.

¹⁴ Subjekti i referohet AMTP-së nr. ***, datë 21.7.1992, sipas së cilës familja e saj e origjinës është pajisur me 10,630 m² tokë të llojit arë dhe pemtore¹⁴, ndërsa familja e bashkëshortit, me AMTP-në nr. ***, datë 10.3.1991, është pajisur me 11,850 m² tokë bujqësore të llojit arë¹⁴.

¹⁵ Analiza e kryer fillon në fund të tetorit 2012, pasi pagesa e parë nga Shkolla e Magjistraturës është kryer në datën 2.11.2012, sikurse evidentohet nga lëvizjet e llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank.

hua, siç referohet edhe në tabelën nr. 1.

Tabela nr. 1

Përshkrimi	31.10.2012 – 5.1.2014
Pasuritë	510,600
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>10,600</i>
Dhënë hua tek halla, datë 5.1.2014	500,000
Gjendja e likuiditeteve	10,600
Të ardhurat	1,284,950
Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës	611,660 ¹⁶
Paga e bashkëshortit	673,290
Shpenzimet	456,155
Shpenzime jetike 2 persona	328,564
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	127,591
Mundësia për kursime	318,194

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për t'i dhënë hua shumën 500,000 lekë hallës së saj.

5. Gjendje cash në datën 27.1.2017, në shumën 5,500 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: (a) kursime nga shpërblimi në Shkollën e Magjistraturës (shkurt – tetor 2014) në shumën 2,000 euro; (b) dhuratë nga prindërit 2,500 euro në datën 15.7.2014; (c) të ardhura nga paga.

5.1 Subjekti ka deklaruar në mënyrë të saktë gjendjen në fund të çdo viti dhe burimin që ka shërbyer për krijimin e këtyre gjendjeve cash¹⁷.

❖ Komisioni ka analizuar burimet e krijimit të shumës cash deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj.

5.2 Në deklaratën *Vetting*, subjekti dhe bashkëshorti i saj deklarojnë si kurime cash shumën 5,500 euro, e cila është e mbartur nga vite të mëparshme, kështu që janë analizuar burimet e deklaruara nga subjekti për krijimin e gjendjes cash ndër vite.

5.2.1 Sa i takon burimit *kursime nga shpërblimi në Shkollën e Magjistraturës* (shkurt 2014 – tetor 2014) në shumën 2,000 euro, gjendje e cila është deklaruar që në DPDFD më 27.11.2014, u pyet subjekti, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka sqaruar se për periudhën shkurt 2014 – tetor 2014 shuma e përfituar nga Shkolla e Magjistraturës është 471,852 lekë. Në total, për periudhën tetor 2012 – tetor 2014 të ardhurat e saj kanë qenë 1,127,202 lekë dhe 2,500 euro (të dhuruara nga prindërit). Nga këto të ardhura janë kursyer: (i) 500,000 lekë, të cilat i janë dhënë hua hallës (trajtuar në çështjen 4 të këtij relacioni); (ii) 2,000 euro, të cilat janë burim i gjendjes cash në datën 30.10.2014. Ndërkohë, pjesa tjetër është shpenzuar për jetesën. Gjithashtu, për të

¹⁶ Të ardhurat e subjektit nga Shkolla e Magjistraturës nuk janë nga tetori 2012 deri në janar 2014 (përfshirë), sikurse deklaroi subjekti, pasi huaja është dhënë në datën 5.1.2014, ndërsa pagesa për muajin janar është kredituar në bankë, në datën 8.1.2014. Kështu, bursa e janarit në shumën 43,690 lekë nuk është përfshirë në të ardhurat të cilat kanë shërbyer për kursimin e shumës 500,000 lekë.

¹⁷ DPDFD 2014 – gjendje cash në datën 30.10.2014, në shumën 4,500 euro, me burim: (a) kursime nga Shkolla e Magjistraturës shkurt – tetor 2014 në shumën 2,000 euro; (b) dhuratë nga prindërit 2,500 euro; DIPP 2014 – pakësuar gjendja cash, datë 14.11.2014, me 1,000 euro për blerje automjeti; gjendja cash datë 31.12.2014, 3,500 euro; DIPP 2015 – shtuar gjendja cash me 2,000 euro, me burim të ardhura nga paga; gjendja cash më 31.12.2015, 5,500 euro; bashkëshorti deklaroi gjendje cash datë 31.12.2015, 200,000 lekë nga shitja e automjetit; DIPP 2016 – subjekti nuk ka deklarime; bashkëshorti deklaroi gjendje cash datë 31.12.2016, 40,000 lekë; *Vetting* – gjendja cash, datë 27.1.2017, 5,500 euro, me burim: (a) kursimet nga Shkolla e Magjistraturës shkurt – tetor 2014, në shumën 2,000 euro; (b) dhuratë nga prindërit 2,500 euro.

mbuluar shpenzimet e jetesës kanë shërbyer të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit E. K..

5.2.2 Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit për të kursyer këtë shumë për periudhën 6.1.2014 deri në momentin kur ajo është deklaruar si kursim *cash*, në datën 30.10.2014. Nga analiza, sikurse është treguar në tabelën më poshtë, ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi që deri në datën 30.10.2014 të ketë kursyer shumën 2,000 euro ose 220,280 lekë¹⁸.

Tabela nr. 2

Përshkrimi	6.1.2014 – 30.10.2014
Pasuritë	643,164
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>643,164</i>
Gjendja e likuiditeteve	653,764
Të ardhurat	1,611,814
Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës	471,852
Paga e bashkëshortit	471,493
Dhuratë nga prindërit 2,500 euro, datë 15.7.2014	350,275
Kursime të mbartura nga periudha tetor 2012 – dhjetor 2013	318,194
Shpenzimet	366,663
Shpenzime jetike 2 persona	366,663
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	-
Mundësia për kursime	601,987

5.2.3 Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj, likuiditetet në banka dhe shuma *cash* prej 4,500 euro (nga të cilat 2,500 euro të dhuruara nga prindërit dhe 2,000 euro të kursyera nga vetë subjekti), si dhe shpenzimet e jetesës për çiftin. Dhurata prej 2,500 euro nga prindërit është konsideruar si e ardhur dhe është trajtuar si burim më vete në vijim.

Burimi, dhuratë nga prindërit 2,500 euro

5.2.4 Komisioni ka kryer një vlerësim të situatës financiare të prindërve të subjektit nga data 30.4.2012¹⁹ deri në datën e dhënies së dhuratës, 15.7.2014, me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ. Sipas këtyre të dhënave, ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme nga pagat dhe pensionet për periudhën në fjalë, në total në shumën 1,225,359 lekë²⁰. Duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit dhe dokumentet e administruara, shpenzimet e jetesës së prindërve janë reduktuar në 0 (zero), duke u konsideruar si të mbuluara nga produktet bujqësore.

➤ Ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi të krijojnë shumën 2,500 euro për t'ia dhuruar subjektit të rivlerësimit.

Burimi, të ardhura nga paga

5.2.5 Duke filluar nga data 1.11.2014 e në vijim, në analizën financiare të subjektit janë përfshirë pagat e dokumentuara nga puna e saj, sikurse janë dokumentuar me vërtetime nga gjykatat përkatëse ku subjekti ka punuar.

¹⁸ Kursi i këmbimit 1 euro = 140.11 lekë, Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2014.

¹⁹ Ky vlerësim bëhet pas datës së dhurimit prej 2,000 USD, për të mos krijuar mbivendosje.

²⁰ Të ardhurat e nënës së subjektit nga pagat janë 865,882 lekë; të ardhurat e babait nga pensioni për të njëjtën periudhë në shumën 359,477 lekë, janë përlllogaritur sipas shpjegimit të dhënë në pikën 3.6/footnote 11.

➤ Sa i takon mundësisë financiare të subjektit dhe bashkëshortit të saj për të krijuar gjendjen *cash* të likuiditeteve ndër vite, duket se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i krijuar këto kursime nga të ardhurat e tyre (*shihni rezultatin e çdo viti në tabelën "Analiza financiare" për periudhën e rivlerësimit, në fund të kriterit të pasurisë në këtë relacion*).

Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e vlerave *cash*, të deklaruara ndër vite dhe në deklaratën *Vetting*.

6. Automjet tip "Mercedes-Benz" i vitit 2003, me targë *, blerë në datën 14.11.2014, në shumën 1,000 euro.** Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: shuma *cash*, krijuar nga kursime nga bursa e Shkollës së Magjistraturës dhe dhurata nga prindërit. Shpenzime doganore: 34,550 lekë (paguar fillimisht nga shuma *cash* e disponueshme dhe zëvendësuar kjo shumë me të ardhurat nga paga).

6.1 Subjekti e ka deklaruar këtë automjet në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2014 (në vijim DIPP) me të njëjtat të dhëna si në deklaratën *Vetting*.

6.2 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR)²¹ konfirmon të regjistruar në emër të subjektit Nertila Kape automjetin tip "Mercedes Benz", me targë ***. Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se automjeti tip "Mercedes-Benz" i vitit 2003 është blerë në shtetin gjerman nga subjekti i rivlerësimit në datën 14.11.2014, me çmimin 1,000 euro. Sipas dokumentit doganor të datës 27.11.2014, subjekti i rivlerësimit ka paguar taksa doganore në vlerën 32,170 lekë.

❖ **Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të shumës 1,000 euro.**

6.3 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar se ajo ka pasur gjendje *cash* në datën 30.10.2014 shumën 4,500 euro, gjendje e cila është pakësuar me 1,000 euro për blerje automjeti në datën 14.11.2014.

6.4 Në pyetësin nr. 2 subjektit të rivlerësimit iu kërkua sa nga kjo shumë ka qenë nga dhurata e prindërve dhe sa nga kursimet e saj nga Shkolla e Magjistraturës. Në përgjigje, subjekti ka sqaruar se shuma për blerjen e automjetit është marrë nga gjendja *cash* ekzistuese prej 4,500 euro dhe se ajo nuk mund të identifikojë sa nga këto kanë qenë nga kursimet e saj dhe sa nga dhurata e prindërve, pasi paratë janë sende gjenerikisht dhe jo individualisht të përcaktuara.

6.5 Sa i takon ligjshmërisë së shumës *cash*, nga e cila buron shuma 1,000 euro me të cilën është blerë automjeti objekt shqyrtimi, duket se shumata e kursyera dhe të dhuruara *cash* kanë burim të ligjshëm, sikurse analizuar hollësisht në pikën 5 të këtij vendimi.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe rezulton me burime të ligjshme për blerjen e automjetit tip "Mercedes-Benz".

PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, BASHKËSHORTI E. K.

7. Bashkëpronësi mbi tokën bujqësore me sip. 11,850 m² dhe truall me sip. 300 m² në fshatin *.** Pjesa takuese: 20%. Burimi i krijimit: AMTP nr. *** akti, datë 10.3.1993, në bazë të ligjit 7501, "Për tokën".

7.1 Personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti E. K., e ka deklaruar këtë pasur në DPFD-në e vitit 2014 me të njëjtat të dhëna si në deklaratën *Vetting*.

²¹ Përgjigjja e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 16.2.2021.

7.2 Nga dokumentacioni i depozituar në *Vetting* rezulton se në bazë të AMTP-së nr. ***, datë 10.3.1993, familjes së shtetasit N. K. (vjehtëri i subjektit), në fshatin ***, i jepen gjithsej 11,850 m² tokë + 300 m² truall. Nga certifikata familjare e gjendjes datë 1.8.1991 rezulton se në përbërje familjare të shtetasit N. K. ka pesë anëtarë, përfshirë edhe bashkëshortin e subjektit E. K.. Si anëtar i familjes bujqësore bashkëshorti rezulton me 20% pjesë takuese.

7.3 ASHK-ja²² nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo edhe personave të lidhur me të.

Personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti E. K., ka deklaruar saktë pasurinë e paluajtshme si më sipër.

8. Të ardhura të krijuara nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf” i vitit 1992, me targë *, shitur në datën 14.11.2015 në vlerën 200,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

8.1 Në DPDFD-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit E. K. ka deklaruar automjetin tip “Volkswagen Golf” i vitit 1992, me targë ***, blerë në datën 1.12.2011, me çmimin 1,000 euro, me pjesë takuese 100%, me burim të ardhurat nga paga. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2015 bashkëshorti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në datën 14.11.2015, në shumën 200,000 lekë.

8.2 DPSHTRR-ja²³ konfirmon se automjeti tip “Volkswagen Golf” i vitit 1992 ka qenë i regjistruar në emër të shtetasit E. K., i cili e kishte përfituar këtë automjet nga kontrata e shitblerjes së datës 30.11.2011²⁴ nga shtetasi N. K., blerë për çmimin 1,000 euro ose 139,740 lekë²⁵. Për këtë automjet, sipas dokumentit doganor, shtetasi E. K. në datën 29.11.2011 ka paguar taksën doganore në vlerën 22,265 lekë dhe, në total, vlera e automjetit është 162,005 lekë. Më pas, me kontratën e datës 14.11.2015²⁶, shtetasi E. K. i shet automjetin shtetasit F. A. me çmimin 200,000 lekë.

8.3 Komisioni me pyetësin nr. 2 i ka kërkuar subjektit të shpjegojë në lidhje me shitjen e automjetit tip “Volkswagen Golf” në çmimin 200,000 lekë pas 4 vitesh përdorimi, në krahasim me çmimin e blerjes rreth 139,740 lekë, si dhe nëse për këtë automjet janë kryer shpenzime, duke i provuar ato.

8.3.1 Subjekti ka shpjeguar se shitja e këtij automjeti u bë pasi kishin blerë një automjet tjetër. Automjeti tip “Volkswagen” kishte kushtuar në total 162,005 lekë, i cili iu shit shtetasit F. A. kundrejt çmimit 200,000 lekë, rreth 38,000 lekë më tepër nga sa ishte blerë nga bashkëshorti i subjektit E. K.. Gjendja teknike e tij ka qenë e mirë, pa dëmtime dhe nuk ka pasur nevojë për shpenzime riparimi. Subjekti ka shpjeguar se shitja me vlerë rreth 38,000 lekë më tepër ka ardhur pa ndonjë arsye të veçantë, vetëm aq sa është vlerësuar nga palët kontraktuese dhe është rënë dakord prej tyre.

8.3.2 Pavarësisht shpjegimeve të subjektit, për shkak të amortizimit të automjeteve, vlera e tyre vetëm ulet pas disa vitesh përdorimi e, për këtë arsye, në analizën financiare shuma e përfituar nga shitja e automjetit do të barazohet me vlerën e shpenzuar për blerjen e tij, pra 162,005 lekë.

❖ Komisioni ka analizuar burimin e blerjes së automjetit.

²² Shkresë nr. ***prot., datë 3.3.2021, e ASHK Korçë; nr. *** prot., datë 17.2.2021, e ASHK Kolonjë; nr. *** prot., datë 16.2.2021, e ASHK Devoll.

²³ DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 28.7.2023, drejtuar Komisionit.

²⁴ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 30.11.2011, tek përgjigjja e DPSHTRR-së.

²⁵ Sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 30.11.2011, ku 1 euro = 139,74 lekë.

²⁶ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 14.11.2015, tek përgjigjja e DPSHTRR-së.

8.4 Megjithëse automjeti objekt shqyrtimi është blerë në një kohë kur subjekti nuk ishte e emëruar në detyrë e madje as nuk e kishte nisur Shkollën e Magjistraturës, Komisioni ka verifikuar mundësinë e atëherëshme të të fejuarit të saj për ta blerë këtë automjet, pasi vlera e përfituar nga shitja e tij është një e ardhur e deklaruar dhe përdorur gjatë kohës që subjekti ka qenë në detyrë.

8.4.1 Nga analiza financiare për vitin 2011, e treguar në tabelën më poshtë, në të cilën janë analizuar subjekti dhe bashkëshorti i saj, pasi ata kanë nisur bashkëjetesën që në janar të vitit 2011, duket se bashkëshorti i subjektit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti. Janë përfshirë vetëm të ardhurat nga paga të bashkëshortit, shpenzimet dhe likuiditetet në banka për të dy bashkëshortët.

Tabela nr. 3

Përshkrimi	2011
Pasuritë	217,720
Volkswagen Golf ***, blerë më 1.12.2011, bashkëshorti	162,005
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>55,715</i>
Gjendja e likuiditeteve	55,715
Të ardhurat	625,963
Paga e bashkëshortit	625,963
Shpenzimet	277,389
Shpenzime jetike për 2 persona	273,240
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	4,149
Mundësia për kursime	130,854

Personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti E. K., ka deklaruar saktë, si dhe ka pasur burime të ligjshme për të blerë automjetin tip “Volkswagen Golf”.

9. Llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank, me gjendje në shumën 1,103,824.14 lekë, datë 27.1.2017. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: (a) llogari page; (b) të ardhura nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 13.3.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; (c) të ardhura nga kthimi i tarifës së parapaguar prej zyrës së përmbarimit “****” sh.p.k.

9.1 Nga dokumentacioni i depozituar bashkë me deklaratën *Vetting*, rezulton se bashkëshorti E. K. ka përfituar shumën 1,047,386 lekë, me burim “urdhër shpenzimi”, në datën 22.11.2016, nga dega e thesarit në Raiffeisen Bank, nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 13.3.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (largim nga puna).

9.2 Sa i takon burimit të krijimit të kësaj balance, nga lëvizjet e llogarisë se mësipërme është evidentuar se:

- ajo është një llogari page dhe se balanca/teprica e saj është krijuar nga kreditimet e pagës së bashkëshortit të subjektit;
- në datën 1.12.2016 është transferuar në llogarinë e tij shuma 1,046,600 lekë, me përshkrimin “Sa paguar Ministria e Financave për ekzekutim vendimi”;
- në datën 11.1.2017 është transferuar nga shoqëria përmbarimore “****” sh.p.k. shuma 23,600 lekë, me përshkrimin “Kthim tarife e papaguar”.

Konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit me gjendjen e llogarisë në datën e deklaratës *Vetting*, si dhe se balanca e kësaj llogarie është krijuar nga burime të ligjshme.

KONSTATIME TË TJERA

10. Në lidhje me adresën e vendqëndrimit, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting “Njësia Administrative nr. *, ***, rr. ****”, pallati ****, k. ***, ap. ***, Tiranë”**

Komisioni, për të hequr çdo dyshim për ndonjë pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit apo/dhe bashkëshortit të saj në emër të personave të tjerë, ka kryer hetimin si vijon:

10.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting ka deklaruar adresën: *“Njësia Administrative nr. ***, ***, rr. ****”, pallati ****, k. ***, ap. ***, Tiranë... (banoj në shtëpinë e kushëririt të bashkëshortit për të cilin kemi vetëm detyrimin ta ruajmë dhe ta mirëmbajmë)”*.

10.2 Po kështu, edhe në deklaratimet periodike 2012 – 2016, subjekti ka deklaruar po të njëjtën adresë me atë të deklaruar në deklaratën Vetting. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2017 ka deklaruar adresën *“Njësia Administrative nr. ***, rr. ****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë”*. Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se duke filluar nga prilli i vitit 2017 dhe aktualisht banon me qira në apartamentin e lartpërmendur, në pronësi të shtetasit E. dhe V. G., me qira 27,000 lekë/muaj.

10.3 Bashkë me deklaratën Vetting, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 31.10.2016²⁷, me deklarues shtetasin L. Zh., i cili deklaron: *“Në banesën time, e cila është ende në proces legalizimi, i kam dhënë të drejtën shtetasit E. K. (kushëriri im) të jetojë prej datës 27.1.2011 e në vazhdim. Me këtë shtetas nuk kam asnjë kontratë qiraje apo tjetër, por detyrimi i tij i vetëm ka qenë dhe vazhdon të jetë ruajtja dhe mirëmbajtja e banesës dhe nuk kam kërkuar apo marrë asnjë shpërblim monetar tjetër prej tij. Shtetasi E. K., bashkë me bashkëshorten e tij, kanë banuar në këtë shtëpi prej datës 27.1.2011 dhe vazhdojnë të banojnë po aty”*.

10.4 Gjithashtu është depozituar edhe një aktmarrëveshje e datës 17.6.2004, lidhur ndërmjet shtetasve M. K. e L. Zh., ku shtetasi M. K. deklaron se është pronar i një shtëpie banimi 4-katëshe, e ndodhur në Tiranë, në rrugën **** dhe se për këtë banesë nuk disponon dokumente pronësie, por do të ndjekë të gjithë procedurën përkatëse dhe në fund do të bëhet kontrata e shitjes. Shtetasi L. Zh. është dakord që të marrë një hyrje në katin e katërt të kësaj ndërtese dhe për këtë ai paguan shumë 3,000,000 lekë, të cilën ia ka paguar tërësisht në dorë shtetasit M. K.. Palët bien dakord që shtetasi M. K. do të ndjekë të gjithë procedurën e legalizimit.

10.5 Edhe në pyetësorin standard subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga marrja e detyrës, tetor 2014, e deri në prill 2017, ka banuar në adresën Njësia Administrative nr. ***, ***, rruga ****, pallati ****, kati ***, apartamenti ***, Tiranë (ndërtesë në proces legalizimi e shtetasit L. Zh., i cili u ka dhënë të drejtën të banojnë dhe ta mirëmbajnë). Subjekti ka depozituar të njëjtën deklaratë noteriale të datës 31.10.2016 dhe të njëjtën aktmarrëveshje, datë 17.6.2004, të përmendur më lart.

10.6 ASHK-ja²⁸ nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit Nertila Kape apo/dhe bashkëshortit të saj.

²⁷ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 31.10.2016, me deklarues L. Zh..

²⁸ Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1 me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021; Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2021; Drejtoria Vendore Tirana Jug me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2021; Drejtoria Vendore Tirana Veri me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2021; Drejtoria Vendore e Zonave të Simuluara me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021.

10.6.1 ASHK-ja²⁹ konfirmon se shtetasi L. Zh. nuk rezulton aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve dhe se nuk është pajisur me leje legalizimi.

10.7 Ujësjetllës Kanalizime Tiranë (në vijim UKT)³⁰ nuk konfirmon kontrata të lidhura me subjektin e rivlerësimit dhe as me personat e lidhur me të. Po kështu, edhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (në vijim FSHU)³¹ nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

10.8 Komisioni me pyetësorin nr. 2 i kërkoi subjektit të shpjegojë në lidhje me shtetasin L. Zh., të depozitohet marrëveshjen e plotë të datës 17.6.2004, të lidhur ndërmjet shtetasve M. K. dhe L. Zh., dokumentin e legalizimit të banesës së shtetasit M. K., se cila është situata financiare e shtetasit L. Zh., për sa kohë që për apartamentin me sip. 93 m², blerë në vlerën 3,000,000 lekë në vitin 2004, nuk ka marrë asnjë pagesë qiraje për 6 vjet me radhë.

10.8.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shtetasi L. Zh. është kushëri i bashkëshortit të saj E. K. (gjyshi i bashkëshortit dhe nëna e L. Zh. janë fëmijë xhaxhallarësh, por, për të vërtetuar këtë lidhje, subjekti nuk ka mundur të marrë një certifikatë në Zyrën e Gjendjes Civile, për arsye se asnjëri prej tyre nuk jeton). Të dyja familjet kanë jetuar në fshatin ***, me banesa afër njëra-tjetrës. Nisur nga marrëdhënia shumë e ngushtë, me qëllim për të ndihmuar bashkëshortin, shtetasi L. Zh. i ka ofruar të drejtën e përdorimit pa kundërshtim të banesës së blerë prej tij në adresën Njësia Administrative nr. ***, rruga “****”, pallati “****”, kati ***, apartamenti ***. Gjatë periudhës janar 2011 – prill 2017, shtetasi L. Zh. banonte në ***, pasi kishte familjen, fëmijët e vegjël, ishte administrator i një autoskolle dhe nuk kishte plan për t’u zhvendosur në qytetin e Tiranës. Në këto rrethana, meqenëse ai vetë nuk do të jetonte në Tiranë, ka ofruar që bashkëshorti të jetonte në banesën e tij pa kundërshtim, por vetëm kundrejt mirëmbajtjes.

10.8.2 Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar, konkretisht aktmarrëveshjen e plotë të datës 17.6.2004, dhe dokumentacionin ligjor që provon se shtetasi L. Zh. ka aplikuar për legalizimin, subjekti ka shpjeguar se të vetmet dokumente që u janë vënë në dispozicion nga ky shtetas kanë qenë deklarata noteriale e datës 31.10.2016 dhe aktmarrëveshja e pjesshme e datës 17.6.2004.

10.8.3 Lidhur me aplikimin për legalizim, subjekti i është referuar deklaramit të shtetasit L. Zh. në mënyrë verbale edhe në deklaratën noteriale. Subjekti ka shpjeguar se dokumentacioni tjetër për banesën, për të cilën ka pasur të drejtën e përdorimit për periudhën janar 2011 – prill 2017, si dhe për gjendjen financiare të shtetasit L. Zh. për atë periudhë kohore, subjekti nuk mund ta sigurojë, duke qenë se aktualisht marrëdhëniet me këtë shtetas janë ndërprerë.

10.9 Komisioni me rezultatet e hetimit kryesisht kërkoi që subjekti të depozitohet kontratën e furnizimit me energji elektrike të lidhur me FSHU-në, të banesës së përdorur prej saj, banesë kjo në pronësi të shtetasit L. Zh..

10.9.1 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve me shtetasin L. Zh., nuk ka mundur të sigurojë prej tij kopje të kontratave respektive lidhur me FSHU-në dhe UKT-në.

10.9.2 Komisioni përpara dërgimit të rezultateve të hetimit subjektit Nertila Kape, në datën 20.12.2023 i është drejtuar FSHU-së për të vënë në dispozicion nëse kishte kontrata të lidhura

²⁹ ASHK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2023.

³⁰ UKT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2021.

³¹ FSHU-ja me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2021.

me shtetasin L. Zh. dhe, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, nga ana e FSHU-së³², në datën 4.1.2024 i është dërguar Komisionit informacioni se shtetasi L. Zh. rezulton abonent me kontratë furnizimi me FSHU-në me nr. *** në instancën Tiranë, duke u krijuar kështu bindja se apartamenti në fjalë është në pronësi të shtetasit L. Zh..

Komisioni, pasi analizoi të gjitha faktet dhe provat, konstaton se nuk ka dyshime për ndonjë pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj në emër të personave të tjerë.

❖ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë periodikisht dhe në deklaratën *Vetting* adresën e vendqëndrimit të saj, sipas kërkesave të ligjit.

11. Analiza financiare e subjektit dhe personit të lidhur për periudhën 30.10.2014 – 2016

11.1 Për efekt të analizës financiare, u pyet subjekti nëse ka pasur banesë me qira në qytetin ku ka punuar dhe, nëse jo, mbi shpenzimet e transportit nga banesa në punë dhe anasjelltas për periudhën 23 qershor – 31 dhjetor 2016, kur ajo ka punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ndërkohë që si adresë banimi është deklaruar ajo e Tiranës.

11.2 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se ajo ka bërë udhëtime vajtje-ardhje nga banesa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe ka deklaruar shpenzimet e transportit, duke specifikuar numrin e udhëtimeve gjatë çdo muaji, mënyrën/mjetet me të cilat ka udhëtuar dhe koston e tyre. Shpenzimet e transportit janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2016.

11.3 Gjatë hetimit administrativ, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit tek Tirana Bank, u evidentuan disa transfertat me përshkrimin “Likuidim detyrimi” midis tij dhe shtetasës V. K. (nëna e tij)³³ dhe një depozitim *cash* nga shtetasja V. B.³⁴. Për këtë arsye, subjektit iu kërkua të sqaronte: (i) këtë marrëdhënie detyrimesh midis bashkëshortit nga njëra anë dhe nënës së tij dhe znj. B. nga ana tjetër; (ii) nëse ka pasur likuidim detyrimesh të tjera në *cash*, jashtë sistemit bankar.

11.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se në lidhje me transfertat nga nëna e bashkëshortit V. K., në total në shumën 39,000 lekë dhe anasjelltas, në shumën 50,000 lekë, këto nuk kanë qenë marrëdhënie detyrimi, por një mbështetje ndaj njëri-tjetrit, për shkak të lidhjeve të ngushta familjare nënë-bir. Përshkrimi “Likuidim detyrimesh” është një pasqyrim standard që është bërë nga banka në transfertat e kryera ndaj njëri-tjetrit.

11.5 Ndërsa sa i takon marrëdhënies së bashkëshortit E. K. me shtetasen V. B., subjekti sqaron se shtetasja në fjalë ka qenë drejtore finance në Njësinë Administrative Qendër ***³⁵, në të njëjtën periudhë kur në këtë institucion ka punuar edhe nëna e bashkëshortit, znj. V. K.. Meqenëse shtetasja V. B. shkante në bankë për të kryer edhe veprime të tjera për shkak të pozicionit të saj të punës, nëna e bashkëshortit i ka dhënë koleges shumën prej 4,000 lekësh për t’ia dërguar djalit të saj E. K.. Kështu që midis bashkëshortit të subjektit dhe dy depozitueseve të përmendura nuk ka pasur marrëdhënie detyrimesh, që janë shlyer qoftë nëpërmjet bankës, ose jashtë sistemit bankar.

³² Përgjigjja e FSHU-së nr. *** prot., datë 4.1.2024, drejtuar Komisionit.

³³ Transferuar nga llogaria e shtetasës V. K.: shuma 25,000 lekë, datë 13.1.2015; shuma 10,000 lekë, datë 10.4.2015; shuma 50,000 lekë është depozituar *cash* nga shtetasi E. K. në datën 24.2.2015 dhe në të njëjtin moment është transferuar në llogarinë e shtetasës V. K., me përshkrimin “Likuidim detyrimi”.

³⁴ Shuma 4,000 lekë është depozituar në datën 19.1.2015 nga shtetasja V. B., me përshkrimin “Likuidim detyrimi”.

³⁵ Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 14.11.2023.

11.6 Për të vërtetuar deklaratimet e saj, subjekti ka paraqitur vërtetim page të nënës së bashkëshortit, ku evidentohet se ajo ka punuar si arkëtare për periudhën janar – qershor 2015 në Njësinë Administrative Qendër ***.

11.7 Nga sa më sipër, shuma prej 50,000 lekësh, e depozituar nga shtetasi E. K. tek nëna e tij në shkurt të vitit 2015, është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të vitit 2015. Ndërsa shumat e dërguara nga nëna e tij, meqenëse nuk janë deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj si burim për krijimin e ndonjë pasurie apo për të mbuluar ndonjë shpenzim, nuk janë konsideruar si të ardhura.

11.8 Analiza financiare për periudhën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në detyrë, është treguar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 4

Përshkrimi	1.11 – 31.12.2014	2015	2016
Pasuritë	9,376	512,366	827,623
Tokë bujqësore sip. 10,630 m ² , Petrushë - PG pjesë takuese 16,6%			
Automjet “Mercedes-Benz” viti 2003, ***	162,005		
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>-152,629</i>	<i>512,366</i>	<i>827,623</i>
Gjendja e likuiditeteve	501,135	1,013,502	1,841,124
Të ardhurat	263,783	1,387,899	2,310,516
Të ardhurat nga paga të subjektit	169,484	996,956	1,051,119
Të ardhurat nga paga të bashkëshortit	94,299	210,338	212,797
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor E. K., datë 1.12.2016			1,046,600
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor E. K., datë 26.5.2015		18,600	
Nga shitja e automjetit “Volkswagen Golf” bashkëshorti		162,005	
Shpenzimet	73,333	498,552	580,461
Shpenzime jetese për 2 persona	73,333	448,552	470,184
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS			31,277
Shpenzime transporti banesë-punë-banesë			79,000
Kaluar nga bashkëshorti në llogarinë e nënës së tij		50,000	
Mundësia për kursime	181,074	376,981	902,432

Nga analiza e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit, pra 30.10.2012 – 31.12.2016, të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

12. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2023, ka dërguar pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Nertila Kape, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 10.7.2023, të KDZH-së dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se:

- i) Formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.
- ii) Për subjektin e rivlerësimit Nertila Kape nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për

kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Nertila Kape.

Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

13. Rivlerësimi profesional, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e përgatitur nga KLGJ-ja, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 27.7.2021, për subjektin e rivlerësimit Nertila Kape.

13.1 Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

13.2 Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotësuar sipas shtojcës së ligjit. Rubrikat janë plotësuar me saktësi, me shkrim të qartë e të lexueshëm. Formulari është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

13.3 Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1 – Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 3.3.2015³⁶. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Në përfundim të gjykimit gjykata ka vendosur “Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e të paditurit të paguajë 8 paga etj.”. Vendimi i mësipërm është ankimuar nga palët në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 30.6.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 3.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Nuk ka informacion nëse ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Vendimi i mësipërm i gjyqtarës Nertila Kape plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dokumenti 2 – Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 14.4.2015³⁷. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Në përfundim të gjykimit, gjykata, me vendimin ka vendosur “Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e të paditurit V. B. t’i paguajë paditësit

³⁶ Që i përket çështjes civile me palë paditëse H. Ç., me të paditur shoqëria “T...” sh.p.k., me objekt “Detyrimi i palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen H. Ç. me 12 paga mujore etj..”.

³⁷ Që i përket çështjes civile me palë: paditës E. D. dhe i paditur V. B. për çështjen me objekt “Detyrimi i të paditurit të përmbushi detyrimin monetar etj.”.

E. D. shumën 40,000 lekë”. Vendimi i mësipërm është ankimuar nga palët në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 3.5.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 14.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Nuk ka informacion nëse ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Vendimi i mësipërm i gjyqtarës Nertila Kape plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dokumenti 3 – Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 18.5.2015³⁸. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Në përfundim të gjykimit gjykata ka vendosur “Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”. Vendimi i mësipërm është ankimuar nga palët në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 14.7.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 18.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Nuk ka informacion nëse ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Vendimi i mësipërm i gjyqtarës Nertila Kape plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLGJ-së dhe pas analizimit të tri dokumenteve nuk konstatohen problematika lidhur me kriterin profesional.

13.4 Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhur me short

Dosja 1 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 25.2.2015 regjistrimi³⁹. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe në përfundim të gjykimit me vendimin nr. ***, datë 31.3.2015, ka vendosur “Deklarimin fajtores të shtetases E. P. për veprën penale, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal etj.”. Vendimi i mësipërm mori formë të prerë pa u ankimuar nga palët. Rezultoi se vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtarja Nertila Kape është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 2 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes është realizuar në respektim të afatit standard 9-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja 2 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 18.12.2014 regjistrimi⁴⁰. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe në përfundim të gjykimit me vendimin nr. ***, datë 12.3.2015, ka vendosur “Pranimin e padisë etj.”. Vendimi i mësipërm mori formë të prerë pa u ankimuar nga palët. Rezultoi se vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtarja Nertila Kape është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 20.3.2018, brenda 8 ditëve nga shpallja në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 3 muaj e 25 ditë. Rezulton se gjykimi është realizuar në respektim të afatit standard 4-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Vlerësohet se vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja 3 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 20.2.2015 regjistrimi⁴¹. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. ***, datë 25.5.2015, ka vendosur “Rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova”. Ndaj këtij vendimi

³⁸ Që i përket çështjes me palë K. A. dhe i paditur shoqëria “Alb...” sh.p.k. me objekt “Detyrim pagim page etj.”.

³⁹ Çështja në ngarkim të së pandehurës E. P., e akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë për kryerjen e veprës penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”. Me vendimin nr. ***, datë 31.3.2015, ka vendosur “Deklarimin fajtores të shtetases E. P. për veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike” dhe dënimin e saj me 3 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimisht të së pandehurës me 2 muaj burgim”.

⁴⁰ Çështja me paditës A. T. dhe i paditur I. S. me objekt “Zgjidhje martesë”.

⁴¹ Çështja me paditës M. T. dhe i paditur F. K. me objekt “Detyrimi i të paditurit të paguajë shumën 3,000 euro etj.”.

ka ushtruar ankim paditësi në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.2.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 25.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Ndaj këtij vendimi paditësi ka depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila nuk e ka shqyrtuar ende çështjen. Rezultoi se vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtarja Nertila Kape është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 4 ditëve nga shpallja në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes është realizuar në respektim të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja 4 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 12.12.2014 regjistrimi⁴². Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe në përfundim të gjykimit me vendimin nr. ***, datë 3.2.2015, ka vendosur “Pranimin e kërkesës”. Vendimi mori formë të prerë pa u ankimuar nga palët. Rezultoi se vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtarja Nertila Kape është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes është realizuar në respektim të afatit standard 4-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja 5 – Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 5.6.2015 regjistrimi⁴³. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe në përfundim të gjykimit me vendimin nr. ***, datë 6.5.2015, ka vendosur “Pranimin e pjesshëm të kërkesave të Prokurorisë. Vleftësimin si të paligjshëm të arrestimit në flagrancë të M. T. etj. Të caktojë si masë sigurimi personal “Detyrimin për t’u paraqitur etj.”. Vendimi mori formë të prerë pa u ankimuar nga palët. Rezultoi se vendimi gjyqësor është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore, në respektim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes është realizuar në respektim të afatit 48 orë, të përcaktuar nga neni 259/5 i Kodit të Procedurës Penale. Vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLGJ-së, si dhe nga analizimi i dokumentacionit, në 5 dosjet nuk konstatohen problematika për sa i përket kriterit profesional.

13.5 Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

13.5.1 Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtaren Nertila Kape nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së.

13.5.2 Gjithashtu, edhe sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore për gjyqtaren Nertila Kape gjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

⁴² Çështja me paditës B. Sh. dhe i paditur M. Sh. me objekt “Zgjidhje martesë”.

⁴³ Çështja me kërkesë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër shtetasit M. T., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Drejtim mjete në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal me objekt “Vleftësimi i ligjshëm i arrestimit në flagrancë të shtetasit M. T. dhe caktimi ndaj tij të masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

13.5.3 Në raportin e KLGJ-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar aftësi të mira profesionale⁴⁴, organizative⁴⁵, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale⁴⁶, aftësitë personale dhe angazhimi profesional⁴⁷.

13.6 Të dhëna nga prokuroritë për kallëzime/procedime penale

13.6.1 Prokuroria e Përgjithshme⁴⁸ ka përcjellë pranë Komisionit përgjigjet e prokurorive të rretheve gjyqësore.

13.6.2 Prokuroritë e rretheve gjyqësore⁴⁹ kanë konfirmuar se pranë tyre nuk rezulton të ketë procedime penale të mosfilluara/pushuara/pezulluara apo të dërguara për gjykim për subjektin e rivlerësimit Nertila Kape.

DENONCIME/ANKESA NGA PUBLIKU

14. Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar dy denoncime/ankesa nga publiku.

14.1 Denoncim i shtetasit L. K.⁵⁰, i cili pretendon se nga gjyqtarja Nertila Kape është marrë vendim i padrejtë, i papabuzar në prova e fakte dhe në kundërshtim me ligjin.

Denoncuesi ka bashkëngjitur vendimin nr. ***, datë 19.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, i dhënë nga gjyqtarja Nertila Kape, për çështjen me paditës Z. K. (babai i denoncuesit) dhe të paditur D. K. dhe L. K., me objekt “Kthimi i sendit pronarëve për pasurinë truall + ndërtesë 55 m²”, për të cilën kërkohet ekzekutimi i detyrueshëm në favor të kreditorit D. K. dhe marrjen e masës së përkohshme “Pezullimi i ekzekutimit” të vendimit nr. ***, datë 18.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Në përfundim të gjykimit, gjykata vendosi të rrëzojë kërkesëpadinë e ngritur nga paditësi Z. K., me arsyetimin se padia është ngritur nga një person i tretë, jo subjekt i ekzekutimit të detyrueshëm, kundrejt kreditorit dhe debitorit të titullit ekzekutiv në ekzekutim të detyrueshëm. Ndaj këtij vendimi shtetasit H dhe Z. K. e kanë ankimuar vendimin e mësipërm në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila nuk e ka shqyrtuar ende çështjen⁵¹.

Komisioni vëren se pretendimi i subjektit për vendim të padrejtë ka të bëjë me themelin e çështjes/vendimmarrjen e subjektit, për të cilën Komisioni mban parasysh nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁴⁴ Ku përfshihen: (a) *Njohuritë ligjore* – subjekti tregon nivel të lartë në njohuritë ligjore; (b) *Arsyetimi ligjor* – ku subjekti shfaq aftësi shumë të mira në arsyetim ligjor.

⁴⁵ Ku përfshihen: (a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – ku rezulton se subjekti ka përballuar me efikasitet një ngarkesë normale pune; (b) *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore* – ku konstatohet se subjekti tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim; (c) *Aftësia për të administruar dosjet*.

⁴⁶ Ku përfshihen: (a) *Etika në punë*; (b) *Integriteti*; (c) *Paanësia*.

⁴⁷ Ku përfshihen: (a) *Aftësitë e komunikimit*; (b) *Aftësia për të bashkëpunuar*; (c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*.

⁴⁸ Përgjigja e Prokurorisë së Përgjithshme nr. *** prot., datë 26.3.2021, drejtuar Komisionit.

⁴⁹ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë nr. *** prot., datë 17.2.2021; Gjirokastrë nr. *** prot., datë 16.2.2021; Berat nr. *** prot., datë 15.2.2021; Korçë nr. *** prot., datë 26.2.2021; Kurbin nr. *** prot., datë 18.2.2021; Elbasan nr. *** prot., datë 22.2.2021; Krujë nr. *** prot., datë 5.3.2021; Lezhë nr. *** prot., datë 19.2.2021; Fier nr. *** prot., datë 26.2.2021; Vlorë nr. *** prot., datë 16.2.2021; Dibër nr. *** prot., datë 24.2.2020; Pogradec nr. *** prot., datë 24.2.2021; Sarandë nr. *** prot., datë 18.2.2021; Kukës nr. *** prot., datë 16.2.2021; Mat nr. *** prot., datë 18.2.2021; Durrës nr. *** prot., datë 24.2.2021; Kavajë nr. *** prot., datë 10.3.2021; Lushnjë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Tiranë nr. *** prot., datë 16.2.2021; Shkodër nr. *** prot., datë 18.2.2021; Pukë nr. *** prot., datë 16.2.2021; Përmet nr. *** prot., datë 15.2.2021.

⁵⁰ Denoncim nr. *** prot., datë 15.5.2018.

⁵¹ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2023, konfirmon ankimin në Gjykatën e Apelit Tiranë.

14.2 Denoncim i shtetasve A. M., A. B. dhe U. e D. K.⁵², të cilët pretendojnë se gjyqtarja Nertila Kape brenda një periudhë 2-mujore ka dhënë 3 vendime gjyqësore në dëm të 3 ankimuesve (vendimi nr. ***, datë 28.5.2018, nr. ***, datë 4.7.2018 dhe nr. *** datë 19.7.2018). Pretendohet se subjekti dyshohet e implikuar në korrupsion, si dhe vendim të padrejtë.

Komisioni ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër⁵³ tri vendimet gjyqësore të përmendura nga denoncuesit. Pas verifikimit të tyre ka rezultuar se vendimi nr. ***, datë 28.5.2018, është dhënë nga subjekti Nertila Kape. Ky vendim i referohet çështjes me paditës A. M. dhe i paditur P. K., me objekt “Rivendosja e servitutit të kalimit për pasuritë e paluajtshme nr. *** etj. dhe pushimi i cenimit që i bëhet pasurisë nr. *** nga mosushtrimi i servitutit”. Në përfundim të gjykimit, subjekti Nertila Kape ka vendosur *rrëzimin e padisë*, me argumentin se padia e paditësit A. M. është e pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim është ankimuar nga paditësi A. M. në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërsa vendimi nr. ***, datë 19.7.2018, ku paditës janë U. dhe D. K., si dhe vendimi nr. ***, datë 4.7.2018, me të dëmtuar akuzues A. B., janë vendime të dhëna nga gjyqtarja G. H. dhe jo nga subjekti Nertila Kape.

Komisioni vëren se:

- Në lidhje me denoncuesin A. M., për pretendimin për vendim të padrejtë që ka të bëjë me themelin e çështjes/vendimmarrjen e subjektit, Komisioni mban parasysht nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Në lidhje me denoncimin e shtetasve A. B. dhe U. e D. K., pretendimet e tyre nuk qëndrojnë, pasi vendimet e çështjeve ku ata janë palë në gjykim janë dhënë nga një gjyqtare tjetër dhe jo nga subjekti Nertila Kape.

GJETJE TË TJERA

15. Komisioni është vënë në dijeni nga informacione të marra nga burime të hapura të mediave *online*⁵⁴ që subjekti i rivlerësimit Nertila Kape është përfshirë në veprime të paligjshme bashkë me një subjekt tjetër M. Ll., për një çështje penale, ku është përfshirë shtetasi B. Z. dhe ndaj subjektit Nertila Kape dhe shtetasit M. Ll. janë regjistruar procedimet penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzim krimi”. Komisioni, për të verifikuar informacionin e pasqyruar në këto media, ka kryer verifikimet përkatëse si vijon:

15.1 Komisioni, për të verifikuar nëse ndaj subjektit Nertila Kape është regjistruar ndonjë kallëzim apo procedim penal në ngarkim të saj referuar informacionit të lartpërmendur, ka administruar përgjigjen e:

- Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁵⁵, e cila konfirmon se pranë saj nuk rezulton që në emër të shtetasës Nertila Kape të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

⁵² Denoncim nr. *** prot., datë 7.12.2018.

⁵³ Përgjigja nr. *** prot., datë 8.5.2023, e GJSHPPJ-së Dibër, drejtuar Komisionit.

⁵⁴ https://***.spak-godet-ne-gjykatën-e-dibres-nen-hetim-dy-gjyqtare-dhe-nje-polic

⁵⁵ Përgjigja e Prokurorisë së Posaçme nr. *** prot., datë 5.12.2023, drejtuar Komisionit.

- Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar⁵⁶, e cila konfirmon se pranë saj nuk rezulton të ketë proces penal ndaj shtetases Nertila Kape, si dhe nuk rezulton të jenë dhënë vendime penale ndaj saj.

15.2 Komisioni, nisur nga informacioni i përmendur më lart, për të verifikuar nëse nga subjekti Nertila Kape janë kryer veprime të paligjshme në lidhje me një çështje penale me palë shtetasin B. Z., ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dosjen penale me palë shtetasin B. Z., gjykuar nga subjekti.

15.3 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrës⁵⁷ ka dërguar dosjen penale të gjykimit në seancë paraprake, pasi dosja e plotë është dërguar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, prej nga është gjykuar dhe më pas është dërguar në Gjykatën e Lartë, ku çështja pritet të gjykohet me nr. ***, datë 12.12.2023.

15.3.1 Nga verifikimi i informacionit, në dosjen penale ka rezultuar se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, nga organet e policisë është bërë referimi për veprën penale “Vrasje e mbetur në tentativë” nga shtetasi A. Sh. kundër viktimës B. Z.

15.3.2 Prokuroria fillimisht ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Vrasje me dashje”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal dhe, pas kryerjes së veprimeve të tjera hetimore, në kërkesën për gjykim drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake, prokuroria ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të shtetasit A. Sh., akuzuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal.

15.3.3 Gjyqtari i seancës paraprake Xh. L., me vendimin nr. ***, datë 23.7.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë për dërgimin në gjyq të çështjes, por duke ndryshuar kualifikimin e veprës penale të dërguar nga prokuroria nga “Plagosje e rëndë me dashje” në “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë.

15.3.4 Në konkluzionet përfundimtare të datës 9.3.2022, drejtuar gjykatës që shqyrton çështjen në themel, prokuroria ka kërkuar “Deklarimin fajtor të të pandehurit A. Sh., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim”.

15.3.5 Në gjykimin në themel, trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, i përbërë nga gjyqtarët Nertila Kape, M. Ll. dhe S. L., në përfundim të gjykimit me vendimin nr. ***, datë 26.4.2022⁵⁸, vendosi “Deklarimin fajtor të të pandehurit A. Sh. për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 11 vite burgim”.

15.3.6 Vendimi i mësipërm është ankimuar nga i pandehuri në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 28.12.2022⁵⁹, vendosi “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 26.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, por me ndryshimin për sa i përket masës së dënimit duke e dënuar të pandehurin me 10 vjet burgim”.

15.3.7 Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nga i pandehuri në Gjykatën e Lartë, e cila ende nuk e ka gjykuar çështjen.

⁵⁶ Përgjigjja e Gjykatës së Posaçme nr. *** prot., datë 15.12.2023.

⁵⁷ Përgjigjja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër nr. *** prot., datë 12.12.2023.

⁵⁸ Vendim i shkarkuar nga faqja zyrtare www.gjykata.gov.al

⁵⁹ Vendimi i shkarkuar nga faqja zyrtare www.gjykata.gov.al

15.4 Komisioni vëren se në lidhje me sa është pretenduar në artikullin e shkruar për subjektin e rivlerësimit Nertila Kape, rezulton se subjekti, në cilësinë e gjyqtarës së trupës gjykuese që shqyrton çështjen në themel, ka vijuar gjykimin e të pandehurit A. Sh. me të njëjtin cilësim të veprës penale, ashtu siç kishte konkluduar edhe gjyqtari i seancës paraprahe, pra i veprës penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë.

15.5 Pas gjykimit të kësaj çështjeje, gjyqtarja së bashku me dy gjyqtarë të tjerë kanë marrë vendimin për dënimin e të pandehurit me 11 vite burgim për këtë vepër penale.

15.6 Vendimi i marrë nga subjekti Nertila Kape bashkë me dy gjyqtarët e tjerë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, e cila la në fuqi vendimin e mësipërm, por me një ndryshim në masën e dënimit nga 11 vite në 10 vite, por në tërësinë e tij dhe në cilësimin e veprës penale vendimi i marrë nga subjekti bashkë me dy gjyqtarët e tjerë nuk është cenuar.

Komisioni nuk konstatoi problematika në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit për rastin në fjalë, që kanë të bëjnë me kriterin profesional apo edhe atë të figurës.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, krerëve V, VI dhe VII të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, e cila në përfundim të hetimit në seancë dëgjimore kërkoi konfirmimin në detyrë duke arritur një nivel të besueshëm për të tria kriteret:

Komisioni konkludoi për subjektin e rivlerësimit Nertila Kape se:

- a. Lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.
- b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “e aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Nertila Kape, gjyqtare pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 15.1.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj